

L I G J
PËR INFORMATAT TË KLASIFIKUARA
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 275/19)¹

KAPITULLI I PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen klasifikimi i informatave, kushtet, kriteret, masat dhe aktivitetet që ndërmerren për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësia e krijuesve dhe shfrytëzuesve të informatave të klasifikuara, shkëmbimi nacional dhe ndërkombëtar, mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji, si dhe çështje tjera në lidhje me qasjen dhe manipulimin me informata të klasifikuara.

Neni 2

Obligim për mbrojtjen e informatave të klasifikuara në pajtim me këtë ligj kanë të gjithë shfrytëzuesit e informatave të klasifikuara që kanë pasur qasje dhe/ose kanë qenë të njoftuar me përmbajtjen e tyre.

Neni 3

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i shfrytëzimit ligjor të informatave të klasifikuara dhe pamundësimi i çfarë do lloji të qasjes së paligjshme apo të paautorizuar, keqpërdorimit dhe komprometimit të informatave.

Neni 4

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për informatat nacionale të klasifikuara dhe për informatat e klasifikuara të pranuar nga shtete tjera dhe organizata ndërkombëtare apo të krijuara në bashkëpunim të ndërsjellë, nëse me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare), nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 5

Për mbrojtjen e informatave të klasifikuara dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare, për realizim të shkëmbimit të informatave të klasifikuara në pajtim me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave tjera nga fusha e informatave të klasifikuara, si dhe për kryerje të punëve tjera të përcaktuara me këtë ligj, kompetente është Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara (në tekstin e mëtejme: Drejtoria).

Kuptimi i shprehjeve të përdorura në këtë ligj

Neni 6

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1. **"Informatë"** është njohuria që mund të bartet në çfarëdo forme;
2. **"Informatë me interes për Republikën e Maqedonisë së Veriut"** është çdo informatë e përpiluar nga organi i pushtetit shtetëror dhe lokal i themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personi juridik i themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, person fizik ose juridik, si dhe nga organ i huaj shtetëror, përkatësisht person fizik apo person juridik i huaj, që ka të bëjë me sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit, integritetin dhe sovranitetin e tij territorial, rendin kushtetues, interesin publik si dhe liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit;

¹ Me këtë ligj bëhet harmonizim me Vendimin e Këshillit nga 23 shtatori 2013 në lidhje me rregullat për siguri për mbrojtjen e informatave të klasifikuara të BE-së, CELEX numër 32013D0488.

3. **"Informatë e klasifikuar"** është informata nga fushëveprimi i punës së ndonjë organi të pushtetit shtetëror dhe lokal i themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personi juridik i themeluar nga Republika apo nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit apo persona tjerë juridikë që ka të bëjë me sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme apo aktivitetet e sigurisë ose të zbulimit të shtetit, që në pajtim me ligj duhet të mbrohet nga qasja e paautorizuar dhe është e shënuar me shkallë përkatëse të klasifikimit në pajtim me këtë ligj. Informata të klasifikuara mund të paraqesin edhe dokumente, mjete teknike, makina, pajisje, përkatësisht komponentë të veçuar apo armë ose vegla që janë prodhuar apo janë në proces të prodhimit, si dhe zbulimet konfidenciale që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe janë në interes të sigurisë së shtetit;

4. **"Dokument"** është çdo tekst i shkruar, draft apo skicë, riprodhim, kopje, fotografi, regjistrim audio, video, magnetik, elektronik, optik apo lloj tjetër i regjistrimit në të cilin janë të përmbajtura informata;

5. **"Dëm"** është cenim i interesave të shtetit si pasojë e rrezikimit të sigurisë së informatave të klasifikuara me interes për Republikën e Maqedonisë së Veriut apo informatave të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut është e obliguar që t'i mbrojë në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

6. **"Rrezik i sigurisë"** është mundësi për cenim të sigurisë së informatës së klasifikuar;

7. **"Siguri e informatës së klasifikuar"** është përmbledhje e aktiviteteve dhe masave me të cilat sigurohet mbrojtja e informatave të klasifikuara nga qasja e paautorizuar dhe manipulimi i paautorizuar;

8. **"Certifikatë e sigurisë për person fizik"** është dokument me të cilin vërtetohet që për personin fizik nuk ekziston rrezik i sigurisë për qasje dhe manipulim me informata të klasifikuara;

1. **"Certifikatë e sigurisë për person juridik"** është dokument me të cilin vërtetohet që për personin juridik nuk ekziston rrezik i sigurisë dhe se posedon kapacitete fizike apo organizative për manipulim me informata të klasifikuara dhe/ose për ruajtje të informatave të klasifikuara, në pajtim me ligjin;

2. **"Leje për qasje në informatat e klasifikuara"** është dokument me të cilin vërtetohet që personi i huaj fizik apo juridik ka certifikatë të sigurisë të lëshuar në shtetin amë dhe ka të drejtë për qasje dhe shfrytëzim të informatave të klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

3. **"Nevojitet të dijë"** është parim sipas të cilit përcaktohet shfrytëzuesi i cili ka nevojë për qasje në informatat e klasifikuara për shkak të kryerjes së funksionit apo të detyrës zyrtare dhe autorizimeve zyrtare, të veprimtarisë apo për zbatim të marrëveshjeve të klasifikuara;

4. **"Krijues i informatës së klasifikuar"** është përpunuesi i autorizuar i informatës së klasifikuar. Krijues të informatave të klasifikuara janë organet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga Republika apo nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe personat tjerë fizikë apo juridikë, që krijojnë informata me rëndësi për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme dhe aktivitetet e sigurisë dhe zbulimit të shtetit;

5. **"Diseminim i informatave të klasifikuara"** paraqet shpërndarje të informatave të klasifikuara në pajtim me parimin —Nevojitet të dijë|| për personat të cilët posedojnë certifikatë përkatëse të sigurisë;

6. **"Shfrytëzues i informatës së klasifikuar"** është personi fizik apo juridik i cili ka nevojë për qasje në informatat e klasifikuara për shkak të kryerjes së funksionit, detyrës zyrtare dhe autorizimeve zyrtare apo për zbatim të marrëveshjeve të klasifikuara dhe i cili ka certifikatë sigurie, të përshtatshëm me klasifikimin e informatës;

7. **"Manipulim me informata të klasifikuara"** është proces i cili e përfshin çdo veprim me informatat e klasifikuara në kohëzgjatje të ekzistimit të tyre. Kjo nënkupton krijim, evidencë, transferim, shfrytëzim, shpërndarje, riklasifikim, deklasifikim, arkivim dhe asgjësim të tyre;

8. **"Brez i sigurisë"** është hapësirë rreth objektit që paraqet distancë minimale nga objekti nga i cili mund të rrezikohen objekti dhe informatat e klasifikuara në të;

9. **"Zonë e sigurisë"** është hapësirë apo lokal në objekt në të cilin manipulohet dhe në të cilin ruhen informatat e klasifikuara deri në shkallën "SEKRET SHTETËROR" dhe ka nevojë për mbrojtje përkatëse fizike;

18. **"Zonë administrative"** është hapësirë e mbrojtur qartësisht që vendoset rreth dhe para zonave të sigurisë në të cilat ekzistojnë mundësi për kontroll të personave dhe automjeteve;

19. **"Marrëveshje e klasifikuar"** është secila formë e marrëveshjes apo marrëveshje që rezultojn nga ajo, duke i përfshirë edhe negociatat për lidhje të saj, që përmban apo mundëson qasje në informatat e klasifikuara;

20. **"Oficer për siguri të informatave të klasifikuara"** është personi i autorizuar nga personi përgjegjës në organin e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personi juridik i themeluar nga Republika apo nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit ose në personin juridik që ka për detyrë të kujdeset për kryerje efikase dhe të koordinuar të të drejtave dhe obligimeve që rezultojnë nga ky ligj;

21. **"Siguri kriptografike"** është komponentë e sigurisë së sistemeve komunikuese informative që përfshin mbrojtjen kriptografike, menaxhimin me materialet kriptografike dhe zhvillim të metodave të mbrojtjes kriptografike, të cilat zbatohen nëpërmjet shifrës, kodit apo nënshkrimit digjital;

22. **"Mbrojtje kriptografike"** është aktivitet i planit operativ në sistemin e materialeve kriptografike dhe produkteve të cilat shfrytëzohen për mbrojtjen e informatave të klasifikuara nga qasja e paautorizuar gjatë përpunimit, manipulimit dhe ruajtjes së informatave të klasifikuara;

23. **"Produkt kriptografik"** është softuer, sistem apo aparat me të cilin bëhet mbrojtja kriptografike;

24. **"Materiale kriptografike (kripto materiale)"** janë algoritma kriptografikë, module kriptografike harduerike dhe softuerike, kripto çelësa, udhëzime për implementimin e tyre dhe dokumentacioni shoqërues;

25. **"Akreditim i sigurisë të sistemeve komunikuese informative"** është proces i aprovimit formal të sistemeve komunikuese informative për punë deri në shkallën e përcaktuar të klasifikimit, në kushte të veçanta të sigurisë në rrethin e tij operativ dhe në nivel të pranueshëm të rrezikut të sigurisë;

26. **"Procesi i menaxhimit me rrezik të sigurisë"** është proces i identifikimit, kontrollimit, minimizimit apo eliminimit të ngjarjeve që mund të ndikojnë mbi sigurinë e një organizate apo të sistemit që ajo e shfrytëzon;

27. **"Sistem komunikues informativ (SKI)"** është secili sistem i cili mundëson krijimin, ruajtjen, përpunimin apo bartjen e informatave në formë elektronike. Sistemi komunikues informativ i përfshin të gjitha mjetet e nevojshme për funksionimin e tij, si infrastrukturën, organizimin, personelin dhe burimet tjera informative, komunikuese dhe elektronike.

KAPITULLI I DYTË

KLASIFIKIMI I INFORMATAVE DHE SHKALLËT E KLASIFIKIMIT

Neni 7

Me klasifikimin e informatës caktohet shkalla e mbrojtjes së informatës që duhet të jetë përkatëse me shkallën e dëmit që do të shkaktohej për Republikën e Maqedonisë së Veriut me qasjen e paautorizuar ose përdorimin e paautorizuar të informatës.

Informatat që janë lëndë e klasifikimit kanë të bëjnë me: sigurinë publike; mbrojtjen; punët e jashtme; aktivitetet e sigurisë, të zbulimit dhe të kundërzbulimit të shtetit; sistemet, pajisjet, zbulimet, projektet dhe planet me rëndësi për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme; kërkimet shkencore dhe çështjet teknologjike, ekonomike dhe financiare me rëndësi për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 8

Klasifikimi i informatave bëhet sipas përmbajtjes së tyre.

Shkallën e klasifikimit të informatës e cakton krijuesi i informatës, ndërsa me autorizimin e tij me shkrim edhe personi tjetër.

Informata shënohet me njërën nga shkallët e klasifikimit:

- SEKRET SHTETËROR,
- TEPËR SEKRET, - SEKRET dhe - INTERNE.

Neni 9

Informata e klasifikuar me shkallën "SEKRET SHTETËROR" është informata zbulimi i paautorizuar i së cilës do të shkaktonte rrezikim dhe shkaktim të dëmeve të pariparueshme të interesave të përhershme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Informata e klasifikuar me shkallën "TEPËR SEKRET" është informata zbulimi i paautorizuar i së cilës do të shkaktonte jashtëzakonisht dëm serioz për interesat vitale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Informata e klasifikuar me shkallën "SEKRET" është informata zbulimi i paautorizuar i së cilës do të shkaktonte dëm serioz për interesat e rëndësishme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Informata e klasifikuar me shkallën "INTERNE" është informata zbulimi i paautorizuar i së cilës do të shkaktonte dëm për punën e organeve të pushtetit shtetëror dhe lokal, të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluara nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, të cilan janë me rëndësi për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme dhe aktivitetet e sigurisë dhe të zbulimit të shtetit.

Neni 10

Gjatë klasifikimit të informatës, krijuesi, përkatësisht personi i autorizuar prej tij, duhet ta shënojë informatën e klasifikuar me shkallën më përkatëse të klasifikimit me të cilin sigurohet mbrojtja e nevojshme e interesave të shtetit dhe siguria nga neni 9 i këtij ligji.

Caktimi i shkallës përkatëse të klasifikimit të informatës bëhet në bazë të vlerësimit të dënimit të mundshëm dhe pasojat që do të dalin nga qasja e paautorizuar në të.

Neni 11

Informatë të klasifikuar me shkallën "SEKRET SHTETËROR" përcaktojnë: Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrat në kuadër të resorëve të vet, prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, shefi i Shtatmadhorisë së Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, drejtori i Agjencisë për Zbulim, drejtori i Agjencisë së Sigurisë Nacionale, drejtori i Agjencisë Teknike Operative, drejtori i Qendrës për Menaxhim me Kriza, drejtori i Drejtorisë për Siguri të Informatave të Klasifikuara, si dhe personat e autorizuar nga subjektet e lartpërmendura.

Nëse ashtu është përcaktuar me ligj, marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare ose rregull tjetër, informatë të klasifikuar me shkallën "SEKRET SHTETËROR" përcaktojnë edhe personat e paraparë në ato akte.

Neni 12

Informatat me zbulimin e të cilave do të zvogëlohet efikasiteti i punës së organeve të pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, e marrin shenjën "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR".

Shenja "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR" nuk paraqet shkallë të klasifikimit, por në informatat e tilla nuk lejohet qasja e lirë.

Mënyrën e ruajtjes dhe menaxhimit me informatat me përdorim të kufizuar me urdhëresë më afërsisht i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 13

Nëse në një informatë janë përfshirë të dhënat për më shumë shkallë të klasifikimit, krijuesi ka për detyrë ta përcaktojë shkallën e klasifikimit të secilës prej tyre veçmas.

Tërësia e informatës klasifikohet sipas shkallës më të lartë të klasifikimit, ndërsa në faqen e parë të materialit shënohen pjesët tjera me shkallët e klasifikimit që i takojnë informatës.

Nëse një pjesë e dokumentit përmban informatë të klasifikuar me shkallë më të lartë të klasifikimit, ajo pjesë mund të veçohet si dokument i veçantë me shkallë përkatëse të klasifikimit.

Fusnotat nuk do të klasifikohen përveç nëse përmbajnë ose zbulojnë informata të klasifikuara.

Për shkak të shmangies së rrezikut të sigurisë përdorimi i fusnotave duhet të reduktohet në minimum.

Neni 14

Krijuesi i informatës së klasifikuar detyrimisht e shënon në vend të dukshëm shkallën e klasifikimit të saj, në pajtim me këtë ligj.

Neni 15

Nëse informata nuk shënohet me shkallën e klasifikimit, ndërsa krijuesi nuk mund të përcaktohet ose ka pushuar të ekzistojë, klasifikimin e informatës e bën trashëgimtari juridik i krijuesit.

Nëse nuk mund të përcaktohet as trashëgimtari juridik nga paragrafi (1) i këtij neni, shënimin e shkallës së informatës së klasifikuar e bën Drejtoria.

Neni 16

Me riklasifikim bëhet ndryshimi i shkallës së klasifikimit të informatës.

Ndryshim të shkallës së klasifikimit bën krijuesi, ndërsa me autorizimin e tij me shkrim edhe personi tjetër.

Për ndryshimin e shkallës së klasifikimit të informatës detyrimisht njoftohen shfrytëzuesit e informatës.

Mënyrën e ndryshimit të shkallës së klasifikimit të informatës me urdhëresë më afërsisht e rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 17 Klasifikimi i informatës pushon:

- në datën e shënuar në dokument,
- me ndodhjen e ngjarjes së caktuar të theksuar në dokument,
- me skadimin e periudhës kohore të shënuar në dokument dhe
- me deklasifikim.

Neni 18

Me deklasifikim bëhet ndryshimi nga informata e klasifikuar në informatë që është e paklasifikuar.

Deklasifikimin nga paragrafi (1) i këtij neni e bën krijuesi i informatës ose personi i autorizuar prej tij, për çfarë detyrimisht i njofton shfrytëzuesit e informatës.

Mënyrën e deklasifikimit të informatës me urdhëresë më afërsisht e rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 19

Krijuesi i informatës së klasifikuar e shënon periudhën kohore ose ngjarjen me të cilën informata mund të riklasifikohet ose deklasifikohet.

Periudha kohore ose ngjarja me të cilën informata e klasifikuar mund të riklasifikohet ose deklasifikohet nuk mund ta tejkalojnë periudhën prej dhjetë vitesh, përveç në rast kur informatës së klasifikuar i nevojitet mbrojtje më afatgjatë e përcaktuar me ligj.

Neni 20

Informatën e klasifikuar me shkallën "SEKRET SHTETËROR" krijuesi e shqyrton dhe e vlerëson në periudhë jo më të gjatë se dhjetë vjet që të vlerësohet nevoja nga mbajtja e mëtejshme e klasifikimit.

Informata e klasifikuar me shkallën "TEPËR SEKRET" shqyrtohet dhe vlerësohet në periudhë jo më të gjatë se pesë vjet që të vlerësohet nevoja nga mbajtja e mëtejshme e klasifikimit.

Informata e klasifikuar me shkallën "SEKRET" shqyrtohet dhe vlerësohet në periudhë jo më të gjatë se tre vjet që të vlerësohet nevoja nga mbajtja e mëtejshme e klasifikimit.

Informata e klasifikuar me shkallën "INTERNE" shqyrtohet dhe vlerësohet në periudhë jo më të gjatë se dy vjet që të vlerësohet nevoja nga mbajtja e mëtejshme e klasifikimit.

Neni 21

Nëse me informatën e klasifikuar fshihet tejkalmi i autorizimit, keqpërdorimi i funksionit ose ndonjë veprim tjetër joligjor, përkatësisht vepër penale, informata e tillë nuk do të konsiderohet e klasifikuar.

Personave që do ta denoncojnë informatën nga paragrafi 1) i këtij neni në organin kompetent në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve, u garantohet mbrojtja në pajtim me ligjin.

Informatat e klasifikuara të shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare

Neni 22

Informatat e klasifikuara të shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare me të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje ndërkombëtare ose në të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka aderuar, e mbajnë shkallën e klasifikimit e cila shfrytëzohet në atë shtet ose organizatë ndërkombëtare.

Neni 23

Diseminimi i informatave të huaja të klasifikuara bëhet në pajtim me parimin "nevojitet të dijë" dhe posedimin e certifikatës përkatëse të sigurisë.

Mënyrën e caktimit të shfrytëzuesve dhe kryerjen e diseminimit të informatave të marra të huaja të klasifikuara me udhëresë më afërsisht i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KAPITULLI I TRETË

KRITERE, MASA DHE AKTIVITETE PËR MBROJTJEN E INFORMATAVE TË KLASIFIKUARA

Neni 24

Për mbrojtjen e informatave të klasifikuara, ndërmerren masa dhe aktivitete për sigurinë industriale, fizike dhe administrative, sigurinë e sistemeve komunikuese informative, si dhe për sigurinë e personave-shfrytëzues të informatave të klasifikuara.

Neni 25

Kritere që veçanërisht merren parasysh gjatë përcaktimit të masave për mbrojtjen e informatave të klasifikuara janë:

- shkalla e klasifikimit,
- vëllimi dhe forma e informatës së klasifikuar dhe
- vlerësimi i rrezikut për sigurinë e informatës së klasifikuar.

Siguria administrative

Neni 26 Masa dhe aktivitete për sigurinë administrative janë:

- caktimi i shkallës së klasifikimit dhe shënimi i informatës së klasifikuar,
- pranimi dhe evidenca e informatës së klasifikuar,
- caktimi i mënyrës së ruajtjes, manipulimit dhe kontrollit të informatës së klasifikuar,
- reproduksioni, përkthimet dhe ekstraktet e informatës së klasifikuar dhe caktimi i numrit të ekzemplarëve dhe shfrytëzuesve,
- diseminimi i informatave të klasifikuara,
- bartja e informatave të klasifikuara, dhe
- mënjanimi dhe shkatërrimi i informatave të klasifikuara.

Masat dhe aktivitetet për siguri administrative me urdhëresë më afërsisht i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Siguria fizike

Neni 27

Siguria fizike realizohet me zbatim të masave fizike dhe teknike mbrojtëse me qëllim të pengimit të qasjes së paautorizuar në informatat e klasifikuara.

Masat për siguri fizike duhet të pengojnë hyrje të fshehtë ose të dhunshme nga personi i paautorizuar, të zmbrapsin, të pengojnë dhe detektojnë aktivitete të paautorizuara, si dhe të mundësojnë ndarje të personelit në qasjen e tyre në informatat e klasifikuara në pajtim me principin "nevojitet të dijë".

Masat për siguri fizike zbatohen në objekte, ndërtesa, zyra, hapësira dhe lokacione tjera në të cilat manipulohen, ruhen ose përpunohen në mënyrë elektronike informatat e klasifikuara.

Hapësirat në të cilat ruhen informata të klasifikuara me shkallë "SEKRET" dhe më lartë, vendosen si zona të sigurta.

Për mbrojtjen e informatave të klasifikuara me shkallë "SEKRET" dhe më lartë shfrytëzohet pajisje, sisteme ose mjete tjera teknike të cilat përmbushin standarde minimale, të cilat i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Neni 28

Masa dhe aktivitete për siguri fizike janë:

- vlerësimi për rrezikim të mundshëm të sigurisë së informatave të klasifikuara,
- caktimi i brezit të sigurisë rreth objektit,
- caktimi i zonave të sigurisë dhe administrative,
- organizimi i mbrojtjes fizike dhe aplikimi i mjeteve teknike për sigurimin e objekteve dhe hapësirave në të cilat gjenden informata të klasifikuara,
- kontrolli i hyrjes, lëvizjes dhe daljes së personave dhe mjeteve për bartje të informatave të klasifikuara, dhe
- sigurimi fizik gjatë bartjes së informatave të klasifikuara jashtë zonave të sigurisë.

Masat dhe aktivitetet për siguri fizike me urdhëresë më afërsisht i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Siguria e personave-shfrytëzues të informatave të klasifikuara

Neni 29

Masa dhe aktivitetet për siguri të personave-shfrytëzues të informatave të klasifikuara janë:

- caktimi i oficerit për siguri dhe informata të klasifikuara,
- kontroll sigurie, - lëshimi i certifikatës së sigurisë,
- lëshimi i lejes për qasje në informatat e klasifikuara dhe
- kontrolli dhe vlerësimi i aftësisë për veprim me informata të klasifikuara.

Masat dhe aktivitetet për siguri të personave shfrytëzues të informatave të klasifikuara me urdhëresë më afërsisht i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Siguria e sistemeve komunikuese informative

Neni 30

Siguria e sistemeve komunikuese informative është zbatimi i masave të sigurisë për mbrojtje të sistemeve të komunikimit, informacionit dhe sistemeve tjera elektronike dhe të informatave të klasifikuara të cilat krijohen, ruhen, përpunohen ose barten në këto sisteme, me qëllim të sigurimit të konfidencialitetit, integritetit, arritshmërisë, autencitetit dhe parevokueshmërisë së tyre.

Për shkak të sigurimit të qëllimeve nga paragrafi (1) i këtij neni implementohet sistem adekuat i masave për siguri administrative dhe fizike, siguri të sistemeve komunikuese informative, si dhe për siguri të personaveshfrytëzues të informatave të klasifikuara, me qëllim krijimin e mjedisit të sigurisë në të cilin funksionojnë sistemet e komunikimit, informative ose sistemet tjera elektronike.

Sistemi i masave të sigurisë të sistemeve komunikuese informative doemos duhet të bazohet në procesin për menaxhimin me rrezikun e sigurisë.

Neni 31

Masat dhe aktivitetet për siguri të sistemeve komunikuese informative janë:

- akreditimi i sistemeve dhe proceseve komunikuese informative,
- vlerësimi për rrezikim të mundshëm të sigurisë së informatave të klasifikuara me hyrje të paautorizuar në sistemin komunikues informativ në të cilin ruhen, përpunohen dhe transferohen informata të klasifikuara,
- përcaktimi i metodave dhe procedurave të sigurisë për pranim, përpunim, bartje, ruajtje dhe arkivim të informatave të klasifikuara në formë elektronike,
- mbrojtja gjatë krijimit, ruajtjes, përpunimit dhe bartjes së informatave të klasifikuara në sistemet komunikuese informative,

- siguria kriptografike e sistemeve të komunikimit, informatave dhe sistemeve tjera elektronike përmes të cilave krijohen, ruhen, përpunohen me kriptombrojtje dhe barten informata të klasifikuara,
- mbrojtja nga rrezatimi elektromagnetik komprometues,
- caktimi i zonave dhe hapësirave të mbrojtura nga rrezatimi elektromagnetik komprometues dhe
- instalimi i aparateve për ruajtje të informatave të klasifikuara.

Masat dhe aktivitetet për siguri të sistemeve komunikuese informative me urdhëresë më afërsisht i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 32

Masa dhe aktivitete për siguri kriptografike janë:

- planifikimi, organizimi dhe implementimi i sigurisë kriptografike,
- evaluimi dhe miratimi i kriptomaterialeve dhe kriptoprodhimeve,
- përpunimi dhe zhvillimi i algoritmeve dhe prodhimeve kriptografike,
- planifikimi, organizimi dhe menaxhimi me kriptomateriale,
- zbatimi i masave dhe procedurave për evidencë, manipulim, ruajtje dhe distribuim të sigurtë të kriptomaterialeve dhe kriptoprodhimeve,
- trajnimi i personave për punë me kriptomateriale dhe kriptoprodhime,
- kontrolli i implementimit të masave dhe aktiviteteve për siguri kriptografike dhe mënyrës së përdorimit të materialeve dhe produkteve kriptografike.

Masat dhe aktivitetet për siguri kriptografike me urdhëresë më afërsisht i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 33

Bartja e informatave të klasifikuara përmes sistemeve të komunikimit jashtë zonave të sigurisë bëhet veçanërisht me zbatim të mbrojtjes kriptografike.

Siguria industriale

Neni 34

Masat për siguri industriale zbatohen me qëllim sigurimin e mbrojtjes së informatave të klasifikuara nga kontraktorë dhe subjekte të përfshirë në negociatat para lidhjes së marrëveshjes dhe gjatë realizimit të marrëveshjes së klasifikuar.

Me masat për siguri industriale sigurohet mbrojtje e informatave të klasifikuara gjatë transportit dhe gjatë vendosjes së procedurave për vizitë të personave fizikë dhe juridikë ku manipulohet me informata të klasifikuara.

Për qasje dhe manipulim me informata të klasifikuara gjatë realizimit të marrëveshjeve të klasifikuara, transportit të informatave të klasifikuara dhe vizitave të objekteve ku manipulohet me informata të klasifikuara, personat fizikë dhe juridikë nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni duhet të posedojnë certifikatë adekuate të sigurisë ose leje për qasje në informatat e klasifikuara.

Për nevojën e klasifikimit të marrëveshjes dhe fazave të cilat i paraprijnë lidhjes së marrëveshjes, përfshirë edhe thirrjen publike për pjesëmarrje në prokurimet publike, personi juridik duhet të sigurojë mendim nga oficeri për siguri të informatave të klasifikuara të subjektit i cili e shpall thirrjen publike.

Masat dhe aktivitetet për siguri industriale i përfshijnë masat dhe aktivitetet nga nenet 26, paragrafi (1), 28 paragrafi (1), 29 paragrafi (1), 31 paragrafi (1) dhe 32 paragrafi (1) të këtij ligji.

Masat dhe aktivitetet për siguri industriale me urdhëresë më afërsisht i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këmbimi i informatave të klasifikuara me shtete të huaja dhe organizata ndërkombëtare

Neni 35

Informata e klasifikuar e shtetit të huaj ose organizatës ndërkombëtare është informata të cilën organi kompetent i shtetit të huaj ose organizatës ndërkombëtare i'a ka kaluar Republikës së Maqedonisë së Veriut me obligim që të sigurojë mbrojtje të saj.

Me informatat e klasifikuara të pranuar nga shteti i huaj ose organizata ndërkombëtare veprohet në mënyrë e cila është e paraparë me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare.

Nëse marrëveshja ndërkombëtare nga paragrafi (2) i këtij neni nuk përmban dispozita për mënyrën e veprimit me informata të klasifikuara, veprohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 36

Në rast se ka gjendje lufte, të jashtëzakonshme ose krize në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të organeve kompetente në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ligj, Drejtoria mund të bëjë këmbim të informatave të klasifikuara me shtete të huaja ose organizata ndërkombëtare me të cilat nuk janë të lidhura marrëveshje ndërkombëtare me pëlqim paraprak nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse kjo është në interes të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas përfundimit të gjendjes së luftës, të jashtëzakonshme ose të krizës nga paragrafi (1) i këtij neni, Drejtoria dorëzon raport në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për informatat e klasifikuara të këmbyerat me shtete të huaja ose organizata ndërkombëtare me të cilat nuk janë lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 37

Në pajtim me obligimet e ndërmarra nga marrëveshjet ndërkombëtare, Drejtoria mundëson kryerje të kontrollit të përfaqësuesve të autorizuar të shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare, të mënyrës së shfrytëzimit dhe mbrojtjes së informatave të klasifikuara që prej tyre janë kaluar në shfrytëzim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kontroll të mënyrës së shfrytëzimit dhe mbrojtjes së informatave të klasifikuara të dorëzuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në shtete të huaja ose organizata ndërkombëtare, kryen Drejtoria në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Shfrytëzimi i informatave të klasifikuara

Neni 38

Organi i pushtetit shtetëror dhe lokal i themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personi juridik i themeluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit ose personi fizik ose juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut që ka certifikatë të sigurisë ose organ, institucion i huaj shtetëror ose person i huaj fizik ose juridik i cili ka certifikatë të sigurisë të shtetit amë dhe leje për qasje në informatat e klasifikuara të lëshuar nga Drejtoria, mund të jetë shfrytëzues i informatave në pajtim me principin "nevojitet që të dijë".

Neni 39

Për kryerje të detyrave të punës, personave që manipulojnë me informata të klasifikuara në organet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluara nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, si dhe personave tjerë juridikë dhe fizikë u lëshohet certifikatë sigurie në pajtim me principin "nevojitet të dijë".

Certifikatë sigurie lëshohet për qasje në shkallën adekuate të informatave të klasifikuara.

Për lëshimin e certifikatës së sigurisë për qasje në shkallën adekuate të informatave të klasifikuara, personi i interesuar fizik ose juridik parashtron kërkesë me shkrim në Drejtori.

Kërkesa për lëshimin e certifikatës së sigurisë nga paragrafi (3) i këtij neni parashtrohet përmes oficerit të sigurisë të informatave të klasifikuara në personin juridik.

Procedura për lëshimin e certifikatës së sigurisë për personat e punësuar në Drejtori zbatohet përmes oficerit të sigurisë të informatave të klasifikuara në Drejtori.

Certifikatë të sigurisë nga paragrafi (2) i këtij neni lëshon drejtori i Drejtorisë në bazë të kontrollit dhe vlerësimit të kryer paraprak për ekzistimin ose mosekzistimin e rrezikut të sigurisë për manipulim me informata të klasifikuara.

Neni 40

Certifikatë sigurie për qasje dhe shfrytëzim të informatave të klasifikuara nga të gjitha shkallët, pa kontroll paraprak të sigurisë, për shkak të kryerjes së papenguar të funksionit nga dita e zgjedhjes deri në fund të mandatit marrin: Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, zëvendëskryetarët e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 41

Certifikatë sigurie i lëshohet personit fizik i cili i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- për certifikatën e sigurisë me shkallën "SEKRET SHTETËROR" të mos jetë shtetas edhe i shtetit tjetër,
- për certifikatën e sigurisë me shkallën "TEPËR SEKRET" të mos jetë shtetas i shtetit që nuk është anëtar i NATO-s,
- të ekzistojë nevojë e arsyeshme për shfrytëzim të informatave të klasifikuara në pajtim me principin "nevojitet të dijë",
- të mos ekzistojnë pengesa sigurie për qasje dhe manipulim me informata të klasifikuara që përcaktohet me kontroll operativ,
- personi fizik të ketë aftësi të punës,
- personi t'i ketë mbushur 18 vjet, ndërsa për shfrytëzimin e informatave të klasifikuara të shënuara me shkallën "SEKRET SHTETËROR" t'i ketë të mbushur 21 vjet,
- të mos i jetë shqiptuar sanksioni ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- të posedojë dëshmi që nuk është i dënuar, jo më të vjetër se gjashtë muaj, dhe
- nga kontrolli operativ për personat e theksuar në pyetësin e sigurisë të mos rezultojë ekzistimi i pengesave të sigurisë për qasjen dhe menaxhimin me informatat e klasifikuara.

Para lëshimit të certifikatës, personi duhet të trajnohet për manipulim me informatat e klasifikuara.

Neni 42

Certifikata e sigurisë i lëshohet personit juridik që i përmbush kushtet në vijim:

- të jetë i regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- të ekzistojë nevojë e arsyeshme për qasjen dhe menaxhimin me informatat e klasifikuara në pajtim me parimin "nevojitet të dijë",
- të mos i jetë shqiptuar sanksioni - ndalim për ushtrimin e veprimtarisë,
- të ketë siguruar kushte për sigurinë fizike, sigurinë administrative dhe/ose sigurinë e sistemeve komunikuese informative, nëse këtë e kërkojnë kushtet e marrëveshjes së klasifikuar,
- të ketë siguruar certifikatë të sigurisë për oficer të sigurisë së informatave të klasifikuara në personin juridik,
- të jetë i qëndrueshëm financiarisht dhe ekonomikisht, dhe
- të mos ekzistojnë pengesa të sigurisë për menaxhim me informatat e klasifikuara që përcaktohet me kontrollin operativ.

Stabiliteti financiar dhe ekonomik nga paragrafi (1) nënparagrafi 6) të këtij neni, përcaktohet me këto dokumente të cilat nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj:

- ekstrakt nga regjistrimi i veprimtarisë,
- dokument për bonitet nga organi kompetent,
- dëshmi nga organi kompetent se nuk është hapur procedurë për falimentim ose likuidim,

- dëshmi nga organi kompetent se me aktgjykim nuk i është shqiptuar masa e sigurisë – ndalim për ushtrimin e veprimtarive,
- vërtetim nga organi kompetent për tatimet, kontributet dhe taksat tjera publike të paguara.

Neni 43

Personi juridik konsiderohet i aftë të sigurojë mbrojtjen e informatave të klasifikuara nëse siguron kushte për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e informatave të klasifikuara të përcaktuara me këtë ligj.

Procedura për lëshimin e certifikatave të sigurisë

Neni 44

Plotësimi i kushteve për lëshim të certifikatës së sigurisë vërtetohet përmes kontrollit të sigurisë. Kontrolli i sigurisë nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet në bazë të pëlqimit paraprak me shkrim nga personi fizik ose personi juridik i cili ka parashtruar kërkesë për lëshim të certifikatës së sigurisë, që është pjesë përbërëse e kërkesës nga neni 39 paragrafi (3) i këtij ligji. Nëse personi fizik ose personi juridik gjatë procedurës me shkrim e tërheq pëlqimin e vet për kontroll, procedurë e sërishme për kontroll sigurie nuk mund të zbatohet para skadimit të një viti nga dita e tërheqjes së pëlqimit.

Neni 45

Kontroll sigurie zbatohet para lëshimit të certifikatës së sigurisë personave juridikë dhe personave fizikë për qasje dhe menaxhim me informata të klasifikuara me qëllim që të konstatohet se ekziston apo nuk ekziston rrezik sigurie.

Kontrolli për siguri fillon pas parashtrimit të kërkesë nga neni 39 paragrafi (3) i këtij ligji, në Drejtori. Të dhënat e plotësuara nga pyetësi për siguri paraqesin pjesë të përmbajtjes së kontrollit të sigurisë. Formën dhe përmbajtjen e formularëve të pyetësit për siguri nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton drejtori i Drejtorisë, e pas koordinimit paraprak me shërbimet kompetente të cilat janë të angazhuara për realizim të kontroleve operative të sigurisë.

Neni 46

Pyetësi i plotësuar për kontroll sigurie shënohet me shenjën "PËRDORIM I KUFIZUAR". Të dhënat nga pyetësi i plotësuar i sigurisë nga paragrafi (1) i këtij neni përdoren për qëllimet e kontrollit dhe me ato veprohet në pajtim me ligjin.

Neni 47

Për përdorim të informatave të klasifikuara të shënuara me shkallën "INTERNE" nuk bëhet kontroll sigurie dhe nuk lëshohet certifikatë sigurie.

Personi fizik apo përgjegjës në personin juridik informohet për obligimin për mbrojtje të informatave të klasifikuara nga paragrafi (1) i këtij neni që janë dhënë për këqyrje, përkatësisht manipulim.

Neni 48

Varësisht nga shkalla e informatës së klasifikuar për të cilën është parashtruar kërkesë për certifikatë sigurie për person fizik, bëhet kontroll i sigurisë përkatës me shkallën e informatës së klasifikuar, si në vijim:

- a) nga shkalla e parë për informatë të klasifikuar "SEKRET";
- b) nga shkalla e dytë për informatë të klasifikuar "TEPËR SEKRET" dhe
- c) nga shkalla e tretë për informatë të klasifikuar "SEKRET SHTETËROR".

Neni 49

Me kontroll sigurie të shkallës së parë kontrollohet:

- identiteti i personit (në bazë të dokumentacionit të parashtruar me shkrim) dhe kontrollit operativ i të dhënave për personin nga ana e organit kompetent,
- mosha prej së paku 18 vite,

- shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- aftësia e punës e personit (në bazë të vërtetimit nga organi kompetent) dhe
- ekzistimi i pengesave të sigurisë për qasje dhe menaxhim me informata të klasifikuara te personi (të përcaktuara me zbatim të kontrollit operativ nga ana e organit kompetent).

Neni 50

Me kontroll sigurie të shkallës së dytë kontrollohet:

- identiteti i personit (në bazë të dokumentacionit të parashtruar me shkrim dhe kontrollit operativ të të dhënave për personin nga ana e organit kompetent),
- mosha prej së paku 18 vite,
- shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- aftësia e punës e personit (në bazë të vërtetimit nga organi kompetent) dhe
- ekzistimi i rrezikut mbi sigurinë apo pengesës për qasje dhe menaxhim me informata të klasifikuara te personi – kërkues i certifikatës së sigurisë dhe te personat e shënuar në pyetësin për siguri (me zbatim të kontrollit operativ nga ana e organit kompetent),
- personi të mos ketë shtetësi të shtetit tjetër i cili nuk është anëtar i NATO-s.

Neni 51

Me kontroll sigurie të shkallës së tretë kontrollohet:

- identiteti i personit (në bazë të dokumentacionit të parashtruar me shkrim dhe kontrollit operativ të të dhënave për personin nga ana e organit kompetent),
- mosha prej së paku 21 vite,
- shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- aftësia e punës e personit (në bazë të vërtetimit nga organi kompetent) dhe
- ekzistimi i rrezikut mbi sigurinë apo pengesës për qasje dhe menaxhim me informata të klasifikuara te personi kërkues i certifikatës së sigurisë dhe te personat e shënuar në pyetësin për siguri (me zbatim të kontrollit operativ nga ana e organit kompetent),
- vërtetimi i aftësisë së personit për manipulim me informata të klasifikuara nëpërmjet realizimit të intervistës nga ana e personit të autorizuar nga shërbimet kompetente të cilat i kryejnë kontrollet operative për siguri, - personi të mos ketë shtetësi të shtetit tjetër.

Neni 52

Me kërkesë të Drejtorisë, kontrollet operative për ekzistim të pengesave të sigurisë për qasje dhe menaxhim me informata të klasifikuara i kryejnë:

- Agjencia për Siguri Nacionale për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, përveç për personat e përcaktuar në nënparagrafin 2) të këtij paragrafi dhe
- shërbimet kompetente të Ministrisë së Mbrojtjes për të gjithë të punësuarit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 53

Procedura për zbatim të kontrollit të sigurisë zgjat më së shumti deri në:

- katër muaj për kontroll sigurie të shkallës së parë për personat fizikë,
- gjashtë muaj për kontroll sigurie të shkallës së dytë për persona fizikë,
- gjashtë muaj për kontroll sigurie të shkallës së tretë për persona fizikë dhe
- gjashtë muaj për kontroll sigurie për person juridik.

Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, procedura për kontroll sigurie në shkallë të tretë për personat e përcaktuar në trupat mbikëqyrës që kryejnë mbikëqyrje në zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve, si dhe për ekspertët e angazhuar të akredituar nacionalë dhe ndërkombëtarë teknikë nga ata trupa, në pajtim me Ligjin për ndjekje të komunikimeve, zgjat një muaj nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, procedura për kontroll të sigurisë në shkallë të dytë për personat para themelimit të marrëdhënies së punës në Agjencinë Teknike-Operative, në pajtim me Ligjin për Agjenci Teknike-Operative, zgjat një muaj nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Kohëzgjatja e certifikatave të sigurisë

Neni 54

Certifikata e sigurisë e lëshuar për informatë të klasifikuara me shkallë "SEKRET SHTETËROR" vlen pesë vite.

Certifikata e sigurisë e lëshuar për informatë të klasifikuara me shkallë "TEPËR SEKRET" vlen dhjetë vite.

Certifikata e sigurisë e lëshuar për informatë të klasifikuara me shkallë "SEKRET" vlen dhjetë vite.

Përmbajtjen dhe formën e formularit të certifikatave të sigurisë nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Neni 55

Shfrytëzuesi i informatave të klasifikuara është i obliguar të parashtrojë kërkesë të re për vazhdim të certifikatës së sigurisë më së voni gjashtë muaj para ditës së skadimit të vlefshmërisë së saj.

Për personin fizik dhe juridik që parashtrojnë kërkesë për vazhdim të vlefshmërisë së certifikatës për siguri, bëhet kontroll i përsëritur për siguri në pajtim me këtë ligj në pajtim me shkallën e informatave të klasifikuara që i kalohen për shfrytëzim.

Neni 56

Nëse konstatohet që personi fizik ose personi juridik nuk vepron me informatat e klasifikuara në pajtim me këtë ligj apo tanimë nuk plotësohet ndonjë nga kushtet në bazë të të cilave është lëshuar certifikata e sigurisë, drejtori i Drejtorisë miraton aktvendim për heqje të certifikatës për siguri edhe para skadimit të vlefshmërisë së saj.

Në aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni nuk jepet arsyetim për shkaqet për heqje të certifikatës për siguri.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni për heqje të certifikatës për siguri dhe para skadimit të vlefshmërisë së saj, personi ka të drejtë për ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në lidhje me procedurën për heqje të certifikatës për siguri.

Neni 57

Drejtori i Drejtorisë mund të miratojë aktvendim për refuzim të kërkesës për lëshim të certifikatës së sigurisë për persona fizikë dhe juridikë nëse nuk janë plotësuar kushtet nga ky ligj.

Në aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni nuk jepet arsyetim për shkaqet për refuzim të kërkesës për lëshim të certifikatës për siguri.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni personi kërkesa e të cilit është refuzuar mund të paraqesë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në lidhje me procedurën për lëshim të certifikatës për siguri.

Neni 58

Ankesa nga neni 56 paragrafi (3) dhe neni 57 paragrafi (3) të këtij ligji parashtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Komisionin shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë. Aktvendimi për ankesën nga paragrafi (1) i këtij neni, i miratuar nga Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, është përfundimtar.

Neni 59

Kërkesë për lëshim të sërishëm të certifikatës për siguri me shkallë të njëjtë apo më të lartë mund të parashtrohet:

- pas kalimit të një viti nga plotfuqishmëria apo finaliteti i aktvendimit për refuzim të kërkesës për lëshim të certifikatës për siguri dhe

- pas tre vitesh nga plotfuqishmëria apo finaliteti i aktvendimit për marrje të certifikatës për siguri para skadimit të vlefshmërisë.

Gjatë lëshimit të sërishëm të certifikatës për siguri për personat nga paragrafi (1) i këtij neni, certifikata e sigurisë vlen një vit.

Neni 60

Certifikata e sigurisë shfuqizohet me mbarim të afatit të vlefshmërisë së saj, si dhe në rast të:

- ndërprerjes së funksionit të personave nga neni 40 të këtij ligji,
- ndërprerjes së nevojës për qasje te informatat e klasifikuara në pajtim me parimin "nevojitet të dijë",
- aftësisë së zvogëluar mentale për veprim me informata të klasifikuara e përcaktuar nga institucioni kompetent mjekësor,
- vdekjes së personit fizik apo shuarjes së personit juridik.

Në rastet nga paragrafi (1) nënparagrafët 1), 2), 3) dhe 4) të këtij neni, nëpunësi për siguri të informatave të klasifikuara i kthen certifikatat për siguri për personat fizikë dhe/ose juridikë në Drejtori në afat prej 15 ditësh nga konstatimi i të njëjtave.

Neni 61

Leja për qasje te informatat e klasifikuara shfuqizohet:

- me skadimin e afatit të vlefshmërisë së shënuar në leje,
- me kryerje të detyrës për të cilën është lëshuar,
- nëse nevoja për lëshim të lejes tanimë nuk ekziston apo është ndryshuar dhe
- nëse konstatohet që personi juridik dhe personi fizik nuk vepron me informatat e klasifikuara në pajtim me ligjin.

Neni 62

Obligimi për mbrojtje të fshehtësisë së informatave të klasifikuara vazhdon edhe pas skadimit të vlefshmërisë së certifikatës për siguri.

Neni 63

Për nevojat e procedurës gjyqësore apo procedurës para organit tjetër kompetent në të cilën shfrytëzohen informatat e klasifikuara, subjektet në procedurë është e nevojshme të posedojnë certifikatë sigurie.

Procedura nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet në prani të personit për të drejtat, obligimet apo përgjegjësinë e të cilit vendoset në kuadër të saj dhe kur personi nuk posedon certifikatë sigurie.

Personi nga paragrafi (2) i këtij neni është përgjegjës për plotësim të obligimit për mbrojtje të informatave të klasifikuara në pajtim me këtë ligj.

Në procedurën nga paragrafi 1 i këtij neni, publiku është i përjashtuar.

Në rast kur krijuesi i informatës së klasifikuar nuk e ka dorëzuar informatën e klasifikuar në procedurën nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykata përkatësisht organi kompetent është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i informatës së klasifikuar ta informojë krijuesin dhe Drejtorinë për shfrytëzimin e saj në procedurë.

Neni 64

Drejtorja mban evidencë për certifikatat e sigurisë të lëshuara dhe për pyetësorët e plotësuar për siguri. Drejtori mban evidencë të veçantë për lejet e lëshuara për qasje te informatat e klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i përcakton drejtori i Drejtorisë.

KAPITULLI I KATËRT

ORGANE PËR MBROJTJE INFORMATAVE TË KLASIFIKUARA

Oficeri për siguri të informatave të klasifikuara

Neni 65

Organet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, persona juridikë të themeluar nga Republika apo nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit dhe persona juridikë tjerë, janë të obliguar të krijojnë kushte të domosdoshme për mbrojtje të informatave të klasifikuara dhe të ndërmarrin masa për eliminim të pasojave negative nëse vjen te zbulimi i informatave të klasifikuara.

Për realizim efikas dhe të koordinuar të të drejtave dhe obligimeve të cilat kanë të bëjnë me informatat e klasifikuara, në subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni caktohet oficer për siguri të informatave të klasifikuara.

Neni 66

Personi përgjegjës në subjektet nga neni 65, paragrafi (1) i këtij ligji përcakton një ose më shumë oficerë për siguri të informatave të klasifikuara, varësisht nga numri dhe vëllimi i informatave të klasifikuara me të cilat manipulohet në subjekt.

Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, varësisht nga numri dhe vëllimi i informatave të klasifikuara, personi përgjegjës në subjekt mund t'i kryejë punët për siguri të informatave të klasifikuara.

Oficeri për siguri të informatave të klasifikuara është i obliguar të përpilojë dhe parashtojë raporte tremujore për punën e vet dhe për gjendjen me informatat e klasifikuara drejtpërdrejt te personi përgjegjës, përveç në rastin nga paragrafi (2) i këtij neni.

Nëse në subjekt janë caktuar më tepër oficerë për siguri të informatave të klasifikuara, personi përgjegjës cakton njërin prej tyre për koordinim me Drejtorinë.

Neni 67

Oficeri për siguri të informatave të klasifikuara mund të caktohet nëse i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të mos jetë shtetas i shtetit tjetër,
- t'i jetë miratuar qasje në nivel përkatës të informatave të klasifikuara sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me ligj,
- të ketë kaluar trajnim për oficer për siguri të informatave të klasifikuara,
- të posedojë certifikatë sigurie përkatëse.

Neni 68

Oficeri për siguri të informatave të klasifikuara është i obliguar:

- të kujdeset për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në lidhje me sigurinë e informatave të klasifikuara në subjekt,
- t'i kontrollojë evidencat dhe qarkullimin e materialeve dhe dokumenteve çdo tre muaj,
- të kujdeset për zbatimin e duhur dhe në kohë të arkivimit dhe asgjësimit të informatave të klasifikuara,
- ta zbatojë procedurën për paraqitjen e kërkesave për lëshimin e certifikatës së sigurisë në suaza të subjektit dhe të mbajë evidencë të personave për të cilët është zbatuar procedura,
- ta njoftojë Drejtorinë për skadimin e certifikatave të sigurisë, përfundimin e operacioneve ose risistemimin e shfrytëzuesve të informatave të klasifikuara,
- ta njoftojë Drejtorinë për nevojën për të ndryshuar shkallën e certifikatës së sigurisë,
- ta njoftojë Drejtorinë me shkrim, për çdo ndryshim në të dhënat në pyetësin e sigurisë ose ndryshimet në kushtet për marrjen e certifikatës së sigurisë për të cilën ka ditur ose ka mundur të dijë se ka ndodhur,

- ti evidentojë rastet e qasjes së paautorizuar në informatat e klasifikuara ose komprometimin e tyre dhe për veprimet e ndërmarra dhe menjëherë ta njoftojë Drejtorinë për rastin dhe veprimin e tillë,
- t'i informojë shfrytëzuesit e informatave të klasifikuara së paku një herë në vit për të drejtat dhe detyrat gjatë manipulimit me informatat e klasifikuara,
- të sigurojë ndihmë eksperte gjatë klasifikimit të informatave në subjekt,
- të organizojë trajnim për shfrytëzuesit e informatave të klasifikuara në subjektin për mbrojtjen e informatave të klasifikuara.

Për punët nga paragrafi (1) i këtij neni, oficeri i sigurisë së informatave të klasifikuara harton plan vjetor pune, të cilin ia dërgon personit përgjegjës për miratim. Në rastet kur personi përgjegjës i kryen punët e oficerit të sigurisë së informatave të klasifikuara, ai e harton planin vjetor të punës.

Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara

Neni 69

Drejtoria është organ i pavarur i administratës shtetërore me cilësi të personit juridik.

Drejtoria:

- siguron zbatimin e vazhdueshëm të standardeve ndërkombëtare dhe normativave në marrjen e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e informatave të klasifikuara,
- kryen koordinimin e aktiviteteve në sigurimin e mbrojtjes së informatave të klasifikuara me organet shtetërore dhe institucionet që bëjnë shkëmbimin e informatave të klasifikuara me shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare,
- përgatit, organizon, zbaton dhe përcjell zbatimin e masave dhe aktiviteteve për sigurimin e mbrojtjes së informatave të klasifikuara të cilat i janë kaluar Republikës së Maqedonisë së Veriut për shfrytëzim nga shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare,
- ndërmerr aktivitete për mbrojtjen e informatave të klasifikuara të kaluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare,
- merr pjesë në përgatitjen e planeve dhe programeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së informatave të klasifikuara,
- planifikon dhe realizon bashkëpunim ndërkombëtar për mbrojtjen dhe shkëmbimin e informatave të klasifikuara,
- propozon masa për përparimin e mbrojtjes së informatave të klasifikuara,
- ngre nisma për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare me vendet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e shkëmbimit të informatave të klasifikuara,
- kryen akreditimin e sistemeve dhe proceseve komunikuese informative,
- organizon dhe zbaton trajnime për sigurinë e informatave të klasifikuara,
- bën mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

Drejtoria miraton plan vjetor për punën e vet, dhe përgatit raport të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 70

Në shkëmbimin dhe mbrojtjen e informatave të klasifikuara me NATO-n dhe Bashkimin Evropian,

Drejtoria i kryen detyrat për:

- koordinim dhe zbatim të politikave të sigurisë së NATO-s dhe Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të sigurimit të nivelit adekuat të mbrojtjes së informatave të klasifikuara sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara,
- siguri të komunikimeve për zgjedhjen, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes kriptografike për bartje, përpunimin dhe ruajtjen e informatave të klasifikuara,
- zbatim të akreditimit të sigurisë së sistemeve dhe proceseve komunikuese informative në të cilat shfrytëzohen informatat e klasifikuara,
- marrje të masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e sistemeve komunikuese dhe informative nga rrezatimi i kompromituar elektromagnetik.

Neni 71

Në shkëmbimin dhe mbrojtjen e informatave të klasifikuara me NATO-n, Ministria e Mbrojtjes dhe Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut menaxhon me materialet për mbrojtjen kriptografike të informatave të klasifikuara dhe manipulimin e sigurtë, ruajtjen, shpërndarjen dhe evidentimin e kriptomaterialeve.

Në pjesën e menaxhimit me materialet për siguri kriptografike të informatave të klasifikuara dhe manipulimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe mbajtjen e sigurët të evidencave të kriptomaterialeve, Drejtoria e mbikëqyr implementimin e masave të zbatuara nga organi kompetent.

Regjistrat dhe pikat kontrolluese

Neni 72

Për kryerjen e punëve me kompetencë të Drejtorisë me informatat e klasifikuara të NATO-s, informatat e klasifikuara të Bashkimit Evropian dhe për informata tjera të klasifikuara të huaja krijohen regjistra, nënregjistra dhe pika kontrolluese.

Regjistri vendoset në Drejtori e nënregjistrat dhe pikat e kontrollit vendosen në organe shtetërore të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga Republika dhe personat tjerë juridikë në të cilat manipulohet dhe ruhen informatat e klasifikuara të NATOs, informatat e klasifikuara të Bashkimit Evropian dhe informata tjera të klasifikuara të huaja.

Nga nënregjistrat dhe pikat e kontrollit nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohen informata të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të Drejtorisë dhe kryhet shkëmbimi i informatave të klasifikuara jashtë vendit.

Me kërkesë të shfrytëzuesve të informatave të klasifikuara Drejtoria jep pëlqim për plotësimin e kushteve për krijimin e nënregjistrave dhe pikave të kontrollit.

Shkëmbimi i informatave të klasifikuara midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare bëhet përmes Drejtorisë, nëse me ligj, me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare ose me aranzhman tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 73

Drejtorja i njofton organet kompetente të shteteve të huaja dhe organizatat ndërkombëtare për sigurinë e informatave të klasifikuara të shkëmbyera dhe merr prej tyre njoftime për sigurinë e informatave të klasifikuara që u janë kaluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Neni 74

Me kërkesë të Drejtorisë, organet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga Republika ose komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat e qytetit të Shkupit dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë, i japin informata të nevojshme për kryerjen e punëve në kompetencë të saj.

Neni 75

Me Drejtorinë për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara menaxhon drejtori të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Drejtori emërohet me mandat prej katër vitesh.

Drejtori ka zëvendës, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për kohë prej katër vitesh. Zëvendësdrejtori e zëvendëson drejtorin në rast se mungon ose kur për shkak të sëmundjes dhe arsye tjera nuk ka mundësi ta kryejë funksionin e tij me të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në menaxhim.

Për emërimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit shpallet konkurs publik në tri gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë Republikën e Maqedonisë së Veriut një prej të cilave botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Drejtor dhe zëvendësdrejtor i Drejtorisë mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet si vijon:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) të mos ketë shtetësi të shtetit tjetër;

3) me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

4) të ketë marrë 240 kredi sipas SETK ose shkallën

VII/1 të arsimore;

5) të ketë së paku pesë vjet përvojë pune;

6) të posedojë një nga certifikatat vijuese të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS – së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku nivelin B2,
 - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
 - BULATS – së paku 60 pikë ose - APTIS – së paku nivelin B2 dhe
- 7) të posedojë certifikatë sigurie me shkallë "SEKRET SHITETËROR".

Drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Drejtorisë i pushon funksioni para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar:

- nëse paraqet dorëheqje,
- me kërkesë personale,
- për shkak të plotësimit të kushteve për pension pleqërie të përcaktuara me ligj, me të drejtën e vazhdimin në pajtim me rregullat për marrëdhënie pune,
- për shkak të vdekjes,
- nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor dënohet me dënim me burg me mbi gjashtë muaj.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut i shkarkon drejtorin dhe zëvendës drejtorin e Drejtorisë nëse plotësohet një nga kushtet në vijim:

- nëse konstatohet se nuk i plotëson njërin prej kushteve të përcaktuara në nenin 74 paragrafi 5 të këtij ligji,
- nëse refuzon të paraqesë deklaratë të gjendjes pronësore dhe interesave në pajtim me ligjin ose nëse të dhënat e përfshira në deklaratë janë të pavërteta dhe
- në mënyrë evidente i ka shkëlur rregullat për konflikt të interesit, respektivisht përjashtim në situatat në të cilat drejtori ka ditur ose duhet të ketë ditur për ekzistencën e ndonjë prej arsyeve për konflikt interesi, respektivisht përjashtimit të parashikuar me ligj.

Neni 76

Të punësuarit në Drejtori janë nëpunës administrativë shtetërorë. Lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre për marrëdhënie pune zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë.

Të punësuarit në Drejtori dërgohen në punë në misionet e përhershme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO dhe BE, në pajtim me marrëveshjen e nënshkruar për bashkëpunim të përbashkët me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Gjatë dërgimit, të punësuarit marrin titull në pajtim me dispozitat e Ligjit për punë të jashtme.

Të punësuarit në drejtori duhet të posedojnë certifikatë adekuate sigurie për qasje në informatat e klasifikuara. Niveli i certifikatës së sigurisë përcaktohet me rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtori.

I punësuarit në Drejtori të cilit gjatë marrëdhënies së punës nuk do t'i vazhdohet vlefshmëria e certifikatës së sigurisë ose gjatë kontrollit do të konstatohet se nuk mund të marrë certifikatë sigurie për shkak të ekzistencës së rrezikut të sigurisë për qasje dhe menaxhim me informata të klasifikuara, merret në mënyrë të përhershme në organ ose institucion tjetër shtetëror, në të njëjtin nivel të vendit të punës për të cilin i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në aktin e sistematizimit të institucionit tjetër.

Marrja kryhet në bazë të marrëveshjes së nënshkruar nga personat udhëheqës të të dyja institucioneve.

Të punësuarit i cili merret i përfundon marrëdhënia e punës nëse nuk e nënshkruan marrëveshjen e re të punës në afat prej 15 ditësh nga data në të cilën i është dërguar.

Të punësuarit në Drejtori kanë legjitimacion zyrtar të lëshuar nga drejtori i Drejtorisë.

Formularin e legjitimacionit zyrtar dhe mënyrën e lëshimit të tij i përcakton drejtori i Drejtorisë.

KAPITULLI I PESTË

PLANE DHE PROGRAME PËR PUNËN E DREJTORISË DHE

FINANCIMI I DREJTORISË

Neni 77

Puna e Drejtorisë udhëhiqet dhe realizohet sipas parimeve, normave dhe procedurave të cilat vlejnë në sistemin e planifikimit, programimit dhe punës buxhetore.

Neni 78

Mjetet financiare për nevojat e Drejtorisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mjetet financiare për nevojat e Drejtorisë mund të sigurohen edhe nga burime tjera në pajtim me ligjin. Mjetet financiare për organet shtetërore për nevojat e mbrojtjes, shfrytëzimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të informatave të klasifikuara sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në suaza të mjeteve financiare të atyre organeve.

Organet e pushtetit lokal të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat e qytetit të Shkupit për nevojat e mbrojtjes, shfrytëzimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të informatave të klasifikuara sigurojnë mjete financiare nga burimet personale dhe nga mjetet financiare dhe materiale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KAPITULLI I GJASHTË

MBIKËQYRJA

Neni 79

Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, kryhen Drejtoria përmes inspektorëve për sigurinë e informatave të klasifikuara (në tekstin në vijim: inspektorët). Punët e mbikëqyrjes inspektuese në kuadër të Drejtorisë kryhen në njësi të veçantë organizative.

Neni 80

Në procedurë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat e këtij ligji, e për çështjet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë ligj, zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese më afërsisht rregullohet me Rregulloren që e miraton drejtori i Drejtorisë.

Neni 81

Inspektori që kryen mbikëqyrje inspektuese, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për nëpunës administrativë nevojitet t'i plotësojë kushtet e posaçme si në vijim:

- të ketë fituar 240 kredi sipas SETK, ose të ketë kryer shkallën VII/1,
- të ketë tre vjet përvojë pune në fushën e sigurisë së informatave të klasifikuara,
- të ketë dhënë provimin profesional për inspektor të informatave të klasifikuara.

Mënyrën e dhënies së provimit profesional për inspektorët për informata të klasifikuara, me Rregullore i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Shtesa e rrogës së inspektorit rregullohet me Ligjin për Mbikëqyrje Inspektuese.

Neni 82

Inspektori kryen mbikëqyrje inspektuese në organet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga

Republika ose komunit, Qyteti i Shkupit dhe komunit në Qytetin e Shkupit, si dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë.

Në kryerjen e punës inspektori është i pavarur në punën e vet. Sipas nevojës, me propozimin e udhëheqësit të njësisë organizative për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese, drejtori mund të përcaktojë ekip për mbikëqyrje inspektuese të përbërë nga nëpunës administrativë të Drejtorisë.

Inspektorët janë të detyruar të veprojnë në pajtim me ligjin dhe rregullat.

Inspektorët duhet të sigurojnë zbatim objektiv të ligjit.

Neni 83

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nga neni 79 i këtij ligji, inspektorët janë të autorizuar:

- të kryejnë mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave tjera në fushën e sigurisë së informatave të klasifikuara,
- të propozojnë masa për mënjanimin e parregullsive dhe mangësive të përcaktuara në afat të caktuar dhe
- të ndërmarrin veprime tjera në pajtim me ligjin.

Neni 84

Cilësia zyrtare e inspektorit dëshmohet me legjitimacion zyrtar dhe distinktiv. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët janë të obliguar të legjitimohen.

Legjitimacionin zyrtar dhe distinktivin nga paragrafi (1) i këtij neni, i lëshon dhe heq drejtori i Drejtorisë.

Formularin, formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar dhe distinktit, si dhe mënyrën e lëshimit dhe heqjes së tyre, i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Neni 85

Për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese, organet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga Republika ose komunit, Qyteti i Shkupit dhe komunit në Qytetin e Shkupit, si dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë janë të obliguar të mundësojnë kryerjen pa pengesa të mbikëqyrjes nga sfera e sigurisë së informatave të klasifikuara.

Mbikëqyrja inspektuese mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme ose kontrolluese.

Mbikëqyrja inspektuese e rregullt e përfshin mbikëqyrjen mbi zbatimin e këtij ligji dhe kryhet sipas Planit Vjetor dhe planit mujor të punës të çdo inspektori që i miraton drejtori i Drejtorisë në pajtim me ligjin.

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme kryhet në bazë të iniciativës së paraqitur nga organet e pushtetit shtetëror dhe lokal në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, persona juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunit, Qyteti i Shkupit dhe komunit në Qytetin e Shkupit, persona fizikë apo juridikë, si dhe në rast dyshimi të inspektorit (sipas detyrës zyrtare).

Mbikëqyrja kontrolluese inspektuese kryhet pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktvendimin për eliminimin e mangësive të përcaktuara.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët kanë të drejtë qasjeje dhe shikimi në çdo kohë dhe pa paralajmërim, në objekte, hapësira afariste, hapësira të banimit dhe në hapësira ku përdoren dhe ruhen informatat e klasifikuara.

Për kryerjen e punëve nga paragrafi (6) i këtij neni në hapësirat e banimit, inspektorët janë të detyruar të sigurojnë urdhër gjyqësor.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët mund të kërkojnë praninë e personit të autorizuar nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e punëve policore, për mbrojtjen e tyre.

Neni 86

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori konstaton mangësi dhe parregullsi lidhur me plotësimin e kushteve për siguri të informatave të klasifikuara, merr aktvendim me të cilin urdhëron mënjanimin e mangësive dhe parregullsive të përcaktuara në afat të përcaktuar.

Kundër aktvendimit të inspektorit nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Për ankesën ndaj aktvendimit të inspektorit vendos Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë nga Sfera e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse.

Neni 87

Për mbikëqyrjen e kryer inspektuese, inspektori përpilon procesverbal me konstatim të gjendjes që e dorëzon në mënyrën dhe në afatin e paraparë me ligj.

Për masat e propozuara për mënjanimin e mangësive dhe parregullsive inspektori merr aktvendim me afate për zbatimin e tyre. Personi përgjegjës në subjektin e mbikëqyrjes është i obliguar të veprojë sipas aktvendimit dhe ta informojë inspektorin për aktivitetet e ndërmarra.

Neni 88

Nëse inspektori konstaton se në përdorim gjenden pajisje, mjete teknike, instalime dhe sisteme të cilat nuk u përgjigjen standardeve dhe kriterëve të përcaktuara të sigurisë për mbrojtjen e informatave të klasifikuara, me aktvendim shqipton ndalim për përdorimin e tyre dhe mënjanimin e tyre.

Neni 89

Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konstaton se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë nga çrregullimi i sigurisë së objekteve ose hapësirave, dokumenteve, pajisjeve, sistemeve dhe personave në brezin e sigurisë, zonën e sigurisë ose zonën administrative, me aktvendim shqipton ndalim për shfrytëzimin e hapësirës, objektit ose pjesës së objektit.

Neni 90

Për zbatimin e aktvendimit nga nenet 86, paragrafi (1) dhe 88 të këtij ligji, inspektori kryen vulosjen e objektit në fjalë ose hapësirave.

Mbyllja nga paragrafi (1) i këtij neni shënohet me vulë nga Drejtoria.

Përmbajtjen dhe formën e vulës, si dhe mënyrën e vulosjes, me rregullore i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Neni 91

Pas mënjanimin të mangësive të konstatuara, për shkak të cilave është shqiptuar masa e ndalimit, e me kërkesë me shkrim të subjektit të cilit i shqiptohet masa, inspektori kryen zhvulosjen.

Neni 92

Në kryerjen e mbikëqyrjes mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave tjera nga sfera e sigurisë së informatave të klasifikuara, inspektorët mund të urdhërojnë marrjen e këtyre masave:

- demontimin, zhvendosjen ose mënjanimin e pajisjeve, aparateve, instalimeve dhe sistemeve me të cilat rrezikohet siguria e informatave të klasifikuara,
- përcaktimin e brezit të sigurisë, zonave të sigurisë dhe zonave administrative rreth objektit, hapësirës ose hapësirës në objekt në të cilin përdoren ose ruhen informatat e klasifikuara,
- vendosjen e pajisjeve të sigurisë informatikekomunikuese, sistemeve dhe instalimeve për siguri të informatave të klasifikuara,
- zhvendosjen ose largimin e personave pa certifikatë përkatëse të sigurisë ose pa leje përkatëse për qasje në brezin e sigurisë rreth objektit dhe nga zonat e sigurisë dhe administrative në objektin në të cilin përdoren ose ruhen informatat e klasifikuara,
- zhvendosjen ose largimin e automjeteve pa leje përkatëse për qasje në brezin e sigurisë rreth objektit dhe në zonat administrative në objektin në të cilin përdoren ose ruhen informatat e klasifikuara,
- përpilimin e akteve interne për vlerësim të rrezikut të sigurisë për informatat e klasifikuara dhe për mbrojtjen e tyre në rast të rrethanave të jashtëzakonshme,
- azhurnimin dhe korrigjimin e evidencave të informatave të klasifikuara dhe mënjanimin dhe shkatërrimin e tyre,
- sigurimin e kushteve të përcaktuara për diseminim dhe bartje të informatave të klasifikuara,
- ndalimin e pranimit, përdorimit, lëshimit dhe ruajtjes së informatave të klasifikuara, dhe
- masa tjera për të cilat inspektori do të konstatojë se janë në funksion të mbrojtjes së informatave të klasifikuara në subjektin e mbikëqyrjes.

Neni 93

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektori konstaton shkelje të ligjit dhe dispozitave tjera që paraqet kundërvajtje, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për Kundërvajtje.

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektori konsideron se shkelja paraqet vepër penale, është i obliguar që menjëherë ta informojë drejtorin e Drejtorisë për ngritje të procedurës para organit kompetent.

KAPITULLI I SHTATË

DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 94

Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik të informatave të klasifikuara nëse:

- nuk i zbaton masat për siguri administrative, fizike, të sistemit komunikues informativ, siguri të personaveshfrytëzues të informatave të klasifikuara ose siguri industriale të informatave të klasifikuara, në pajtim me dispozitat e neneve 26, 28, 29, 31, 32 dhe 33 të këtij ligji,
- nuk vepron me informata të klasifikuara, në pajtim me dispozitat e nenit 56 paragrafi 1 të këtij ligji (përveç nëse vepra nuk paraqet vepër penale),
- nuk njofton për ndërprerjen e plotësimit të ndonjë nga kushtet në bazë të të cilëve është dhënë certifikatë e sigurisë, në pajtim me dispozitat e nenit 42 të këtij ligji,
- e pengon realizimin e mbikëqyrjes inspektuese në pajtim me dispozitat e nenit 79 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik shfrytëzues të informatave të klasifikuara për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik - shfrytëzues të informatave të klasifikuara për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 95

Gjobë me shumë prej 1.500 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik-shfrytëzues i informatave të klasifikuara, nëse nuk i ndërmerr aktivitetet e nevojshme për pranimin, përpunimin, përcaktimin e shfrytëzuesve dhe nuk kryen diseminim të informatave të klasifikuara te ata, në pajtim me dispozitat e nenit 26 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik shfrytëzues të informatave të klasifikuara për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik - shfrytëzues të informatave të klasifikuara për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 96

Gjobë në shumë prej 1.500 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit juridik i cili do të veprojë në kundërshtim me obligimin për mbrojtjen e informatave të klasifikuara të shënuara me shkallën "INTERNE" nga neni 47, paragrafi (2) dhe në kuptimin e nenit 2 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 97

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit juridik që në kundërshtim me nenin 12 zbulon informatë me shenjë "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR".

Gjobë në shumë prej 450 deri në 700 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 98

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë i shqiptohet për kundërvajtje oficerit të sigurisë së informatave të klasifikuara, nëse:

- nuk e plotëson ndonjë nga obligimet e veta të cekura në nenin 68 të këtij ligji,
- e pengon realizimin e mbikëqyrjes inspektuese në pajtim me dispozitat e nenit 79 të këtij ligji.

Neni 99

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit juridik-krijues i informatës së klasifikuar që do të veprojë në kundërshtim me nenin 10, paragrafi (2) dhe klasifikon informatë për të cilën nuk është bërë vlerësim i duhur për dëmin dhe pasojat e mundshme.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 100

Gjobë në shumë prej 1.500 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet personit juridik – krijues i informatës së klasifikuar që do të veprojë në kundërshtim me nenin 16, paragrafi (3) dhe nenin 18, paragrafi (2) dhe nuk e lajmëron shfrytëzuesin e informatës së klasifikuar për ndryshimin e shkallës së klasifikimit ose për deklasifikimin e saj.

Gjobë në shumë prej 1000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Procedura e barazimit me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse

Neni 101

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje, inspektori është i obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë kundërvajtëse, para se të dorëzojë kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes.

Inspektori është i obliguar të mbajë evidence për urdhërpagesat e lëshuara kundërvajtëse dhe për rezultatin e tyre.

Në evidencën nga paragrafi (2) i këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht titulli i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi (3) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e vendosjes në evidencë.

Drejtori i përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse.

Për gjithçka që nuk është e përcaktuar me këtë ligj, në lidhje me urdhërpagesën kundërvajtëse zbatohen dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

Neni 102

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurë kundërvajtëse udhëheq dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

KAPITULLI I TETË

DISPOZITA NDËSHKUESE

Zbulimi i informatave të klasifikuara me shkallën "TEPËR SEKRET" dhe "SEKRET"

Neni 103

Ai i cili publikut ose personit të paautorizuar, i kumton, dorëzon ose ia bën të arritshme informatën që është e klasifikuar me shkallën "TEPËR SEKRET" në të cilin ka qasje në pajtim me ligjin dhe me këtë i rrezikon ose cenon interesat vitale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.

Ai i cili publikut ose personit të paautorizuar i kumton, dorëzon ose ia bën të arritshme informatën që e di se është e klasifikuar me shkallën "TEPËR SEKRET" e te e cila ka ardhur në mënyrë joligjore, dënohet me burg prej një deri në tre vjet.

Ai i cili publikut ose personit të paautorizuar, i kumton, dorëzon ose ia bën të arritshme informatën që është e klasifikuar me shkallën "SEKRET" në të cilin ka qasje sipas ligjit dhe me këtë i rrezikon ose i cenon interesat e rëndësishme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dënohet me burg prej një deri në tre vjet.

Ai i cili publikut ose personit të paautorizuar i kumton, dorëzon ose ia bën të arritshme informatën që e di se është e klasifikuar me shkallën "SEKRET" te e cila ka ardhur në mënyrë joligjore, dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Nëse vepra nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, është kryer gjatë kohës së gjendjes së luftës, kryerësi dënohet me burg prej një deri në dhjetë vjet.

Tentimi për veprën nga paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, është i dënueshëm.

Nëse vepra nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, është kryer nga pakujdesia, kryerësi dënohet me dënim me para ose burg deri në një vit.

Zbulimi i paautorizuar i informatës së klasifikuar e përdorur në procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër

Neni 104

Ai që në kundërshtim me ligjin, pa autorizim zbulon informatë të klasifikuar me shkallën e klasifikimit "SEKRET SHTETËROR", për të cilën ka kuptuar në procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër, dënohet me burg deri në pesë vjet.

Nëse informata e klasifikuar është me shkallë të klasifikimit "TEPËR SEKRET" ose "SEKRET", kryerësi dënohet me burg prej një deri në tre vjet.

Tentimi për veprën nga paragrafi 2) i këtij neni, është i dënueshëm.

Nëse vepra nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, është kryer nga pakujdesia, kryerësi dënohet me dënim me para ose burg deri në një vit.

KAPITULLI I NËNTË

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 105

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit për Informata të Klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/2004, 113/2007, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18), do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 106

Dispozitat të cilat i rregullojnë çështjet nga sfera e informatave të klasifikuara do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 107

Certifikatat e sigurisë të lëshuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të vlejnë deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Neni 108

Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara e themeluar me Ligjin për informata të klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/2004, 113/2007, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18), nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të punojë si Drejtori për Siguri të Informatave të Klasifikuara në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 109

Drejtori i Drejtorisë për Siguri të Informatave të Klasifikuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdon ta kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 110

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për informata të klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 9/2004, 113/2007, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18).

Neni 111

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.